ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**

Për aktivitetin e prokurimit:

Nr i Prokurimit	**632-21-2626-5-1-1**
Nr i brendshëm	**632-21-047-511**

Sa i përket tenderit për: **"Zgjerimi i linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare".**

1. Identifikimi i ankuesit*

"Multi Business Group" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

JUSUF GËRVALLA 103 K.II
(Adresa)

PRIZREN *20000*
(Vendi) *(Kodi postar)*

+383 44 168 954
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Jeton Bytyçi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@mbg-ks.com
(Adresa elektronike)

08.09.2021
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontrate: 05.05.2021 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 28.05.2021 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues: 16.08.2021 Kërkesa për rishqyrtim dt:23.08.2021 Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt. 31.08.2021

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar me datën 16.08.2021 jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin (B58) e AK-së ku na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm, ndërsa e ka rekomanduar për kontratë **OE BM Group SH.P.K.**

Ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet dhe faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, tek pika 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar:
Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog të fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Dështmia: Katalog i fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Në katalogun e prezantuar nga BM Group nuk është ofruar ndriçuesi rrugor LED në bazë të karakteristikave të kërkuara në paramasë.

Karakteristikat, të cilat ndriçuesi i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë që nuk i plotëson janë të paraqitura në vijim:
1). Ftohësi: Baza e ndërtuar nga qeramika (pa prani te aluminit)-ndriçuesi i prezantuar nga BM Group nuk e posedon bazën ashtu siç është kërkuar, andaj edhe është i papërgjegjshëm.
2). Dizajn i hapur i ndriçuesit: Ventilim natyral i LED-it. Ndriçuesi duhet ta ketë mundësinë

e rrjedhjes natyrale te ajrit nga poshtë-lartë (shtëpiza e ndriçuesit duhet te jetë e hapur)
Ndriçuesi i prezantuar është i mbyllur, dhe në këtë mënyrë bëhet e pamundur ftohja e tij përmes rrymimit të ajrit. Tashmë dihet që edhe përkundër përparësive të shumta të aplikimit të ndriçuesve rrugor LED, e metë kryesore e tyre është ngrohja e tepërt e tyre gjatë punës, e cila shkakton probleme të shpejta në ndriçues duke shkurtuar në masë të madhe jetëgjatësinë e tyre. Prandaj, projektanti i njoftuar me këtë fakt, me kujdes ka përshkruar këto dy pika të përshkruara më lartë që kanë të bëjnë me eliminimin e këtij problemi të madh.

3) Thjerrëzat: Secili çip (qelule) e LED-it duhet ta përmbajë nga një thjerrëz te veçantë dhe te ndarë nga thjerrëzat e cipave tjera
Ndriçuesi i prezantuar nga BM Group këtë nuk e ka, prandaj nuk mund të sjell fokus të mire të dritës, duke pamundësuar krijimin e një ambienti të këndshëm dhe pa reflektime të panevojshme të dritës. Me përdorimin e çipave (qelulave) të tillë arrihet intensitet shumë më i lartë, fokusim dhe shpërndarje e përkryer e fluksit të dritës.

4) LED moduli: Moduli dhe ne veçanti secili çip i ndriçuesit duhet ta kenë mundësinë qe te ndërrohen ne vend ne rastin e nevojës për servisim
Ndriçuesi i prezantuar nga BM Group nuk e ka këtë mundësi dhe në rast të prishjes së ndonjërës nga qelulat e ndriçuesit duhet të ndërrohet i tërë ndriçuesi me një të ri që gjithashtu shkakton dëmtime të buxhetit.

5) Shtëpiza e ndriçuesit: Shtëpiza duhet të jetë e punuar nga alumini i derdhur nën shtypje dhe ta ketë mundësinë e hapjes pa mjete të punës në rastin e nevojës për servisim.
Ndriçuesi i prezantuar nga BM Group nuk e ka këtë mundësi dhe lehtësi gjatë punës.

6) Këndi i rrotullimit të ndriçuesit:
-15°, -10°, -5°, 0°, 5°, 10°, 15°, 0°-90°
Me këtë karakteristikë ekziston mundësia e përshtatjes së ndriçuesit në kënde të shumta dhe të ndryshme, në mënyrë që ndriçimi i ambientit të jetë sa më efikas, ndërsa ndriçuesi i prezantuar nga BM Group nuk e ka këtë mundësi.

7) Çertifikatat: Ndriçuesi duhet të ketë çertifikatat: CE LVD, CE EMC, IK10, RoHS, ENEC, lm80
Operatori ekonomik nuk e ka prezantuar asnjërën nga çertifikatat e kërkuara.

Sipas kësaj që është thënë më lartë, ndriçuesi rrugor i prezantuar në katalogun e dhënë as përafërsisht nuk i plotëson kërkesat sipas paramasës së projektit.
Ndriçuesit e përshkruar dhe të paraqitur në katalog janë jo kualitativ në krahasim me ndriçuesit e kërkuar me paramasë, janë me çmim shumë më të ultë në treg se sa ndriçuesit e përshkruar dhe si të tillë (duke e marrë parasysh numrin e tyre total të paraparë me projekt) krijojnë diferencë të madhe në vlerë totale të shprehur në Euro, nga ajo që sipas tregut realisht është, por edhe nga vlera e paraparë me dosje të tenderit. Prandaj, nëse operatori ekonomik BM Group shpërblehet me kontratë do të sjell ndriçues me kualitet shumë më të dobët se ata që janë të kërkuar me paramasë, me çmim shumë më të ultë, ndërsa do të paguhet për ndriçuesit që kanë krejtësisht karakteristika tjera dhe kanë çmim shumë më të lartë.
Në pikën e paramasës, e cila përshkruan karakteristikat teknike të ndriçuesit rrugor kërkohet që efikasiteti i ndriçimit për ndriçuesit 100W-ësh të jetë 170lm/W, rrjedhimisht edhe fluksi i dritës për këtë ndriçues duhet të ishte 17000lm/W. Në katalogun e prezantuar nga OE "BM GROUP", paraqitet ndriçuesi rrugor AL LED 100 apo EDGE_II100 me efikasitet të ndriçimit 170 lm/W, por me fluks të ndriçimit 13900lm. Meqenëse, efikasiteti i ndriçimit është 170lm/Ë dhe ndriçuesi rrugor është 100W-ësh, atëherë domosdoshmërisht, fluksi i

dritës për këtë ndriçues duhet të jetë 17000lm. Si rrjedhojë e kësaj, përfundojmë që OE "BM GROUP" ka manipuluar në katalogjet e paraqitura.

OE **Labinot M. Krasniqi B.I**. po ashtu është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar:
Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog të fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Dëshmia: Katalog i fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Në katalogun e prezantuar nga OE Labinot M. Krasniqi B.I. nuk është ofruar ndriçuesi rrugor LED në bazë të karakteristikave të kërkuara në paramasë. Karakteristikat të cilat ndriçuesi i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson janë të paraqitura në vijim:

1). Ftohësi: Baza e ndërtuar nga qeramika (pa prani te aluminit)-ndriçuesi i prezantuar nga OE Labinot M. Krasniqi B.I. nuk e posedon të njëjtin.

2). Dizajn i hapur i ndriçuesit: Ventilim natyral i LED-it. Ndriçuesi duhet ta ketë mundësinë e rrjedhjes natyrale te ajrit nga poshtë-lartë (shtëpiza e ndriçuesit duhet te jetë e hapur)
Ndriçuesi i prezentuar nga OE i lartcekur është i mbyllur dhe në këtë mënyrë bëhet e pamundur ftohja e tij përmes rrymimit të ajrit. Tashmë dihet që e përkundër përparësive të shumta të aplikimit të ndriçuesve rrugor LED, e metë kryesore e tyre është ngrohja e tepërt e tyre gjatë punës, e cila shkakton probleme të shpejta në ndriçues duke shkurtuar në masë të madhe jetëgjatësinë e tyre. Prandaj, projektanti i njoftuar me këtë fakt, me kujdes ka përshkruar këto dy pika të përshkruara më lartë që kanë të bëjnë me eliminimin e këtij problemi të madh.

3) Thjerrëzat: Secili çip (qelule) e LED-it duhet ta përmbajë nga një thjerrëz të veçantë dhe te ndare nga thjerrëzat e cipave tjerë
Ndriçuesi i prezentuar nga OE Labinot M. Krasniqi B.I. këtë nuk e ka, prandaj nuk mund të sjell fokus të mire të dritës, duke pamundësuar krijimin e një ambienti të këndshëm dhe pa reflektime të panevojshme të dritës. Me përdorimin e çipave (qelulave) të tillë arrihet intensitet shumë më i lartë, fokusim dhe shpërndarje e përkryer e fluksit të dritës.

4) LED moduli: Moduli dhe ne veçanti secili çip i ndriçuesit duhet ta kenë mundësinë qe te ndërrohen ne vend ne rastin e nevojës për servisim
Ndriçuesi i prezantuar nga OE Labinot M. Krasniqi B.I. nuk e ka këtë mundësi dhe në rast të prishjes së ndonjërës nga qelulat e ndriçuesit duhet të ndërrohet i tërë ndriçuesi me një të ri që gjithashtu shkakton dëmtime të buxhetit.

5) Shtëpiza e ndriçuesit: Shtëpiza duhet të jetë e punuar nga alumini i derdhur nën shtypje dhe ta ketë mundësinë e hapjes pa mjete të punës në rastin e nevojës për servisim.
Ndriçuesi i prezantuar nga OE Labinot M. Krasniqi B.I. nuk e ka këtë mundësi dhe lehtësi gjatë punës.

6) Në pikën e paramasës, e cila përshkruan karakteristikat teknike të ndriçuesit rrugor kërkohet që efikasiteti ndriçimit për ndriçuesit LED të jetë 170lm/W, ndërsa ndriçuesi i prezantuar nga Labinot M. Krasniqi B.I. i ka vetëm 160lm/W, kështu që nuk e plotëson as këtë kërkesë nga dosja e tenderit
Sipas kësaj që është thënë më lartë, ndriçuesi rrugor i prezantuar në katalogun e dhënë as përafërsisht nuk i plotëson kërkesat sipas paramasës së projektit.
Ndriçuesit e përshkruar dhe të paraqitur në katalogun e OE Labinot M. Krasniqi B.I. janë jo

kualitativ në krahasim me ndriçuesit e kërkuar me paramasë, janë me çmim shumë më të ultë në treg, se sa ndriçuesit e përshkruar dhe si të tillë(duke e marrë parasysh numrin e tyre total të paraparë me projekt) krijojnë diferencë të madhe në vlerë totale të shprehur në Euro, nga ajo që sipas tregut realisht është, por edhe nga vlera e paraparë me dosje të tenderit.

Gjithashtu edhe OE tjetër **ITE Engineering SH.P.K. dhe EVERELIGHT SH.P.K.** i shpallur nga AK-ja si OE i pasuksesshëm është i papërgjegjshëm sepse i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar:
Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog të fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Dëshmia: Katalog i fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Grupi i operatorëve ekonomik ITE Engineering SH.P.K. dhe EVERELIGHT SH.P.K. nuk e plotësojnë kërkesën e lartcekur për faktin se të njëjtit nuk kanë prezantuar katalogun për ndriçuesit LED, por vetëm emrin e ndriçuesit dhe fotografinë e ndriçuesit me mundësinë e klikimit në WEB faqen e prodhuesit, me ç 'rast krijohet konfuzitet dhe nuk kuptohet asnjë nga karakteristikat e ndriçuesit. Andaj ne dyshojmë se ky Grup i Operatorëve nuk e ka plotësuar kriterin e kërkuar, pra nuk e plotësojnë kërkesën e lartcekur për faktin e mos prezantimit të katalogut, prandaj ky grup i operatorëve është i papërgjegjshëm.

OE **N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K**. është i papërgjegjshëm edhe pse AK-ja e ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm i njëjti nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar:
Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog të fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Dëshmia: Katalog i fotokopjuar ose origjinal për materiale elektrike sipas specifikacionit
Në katalogun e prezantuar nga N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K. nuk është ofruar ndriçuesi rrugor LED në bazë të karakteristikave të kërkuara në paramasë. Karakteristikat të cilat ndriçuesi i prezantuar nga OE i lartcekur nuk i plotëson janë të paraqitura si në vijim:

1). Ftohësi: Baza e ndërtuar nga qeramika (pa prani te aluminit)-ndriçuesi i prezantuar nga N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K , i njëjti nuk e posedon fare.

2). Dizajn i hapur i ndriçuesit: Ventilim natyral i LED-it. Ndriçuesi duhet ta ketë mundësinë e rrjedhjes natyrale te ajrit nga poshtë-lartë (shtëpiza e ndriçuesit duhet te jetë e hapur).

Ndriçuesi i prezantuar nga OE i lartcekur është i mbyllur dhe në këtë mënyrë bëhet e pamundur ftohja e tij përmes rrymimit të ajrit. Tashmë dihet që përkundër përparësive të shumta të aplikimit të ndriçuesve rrugor LED, e metë kryesore e tyre është ngrohja e tepërt e tyre gjatë punës, e cila shkakton probleme të shpejta në ndriçues duke shkurtuar në masë të madhe jetëgjatësinë e tyre. Prandaj, projektanti i njoftuar me këtë fakt, me kujdes ka përshkruar këto dy pika të përshkruara më lartë që kanë të bëjnë me eliminimin e këtij problemi të madh.

3) Thjerrëzat: Secili çip (qelule) e LED-it duhet ta përmbajë nga një thjerrëz te veçante dhe te ndare nga thjerrëzat e cipave tjerë
Ndriçuesi i prezantuar nga N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K këtë nuk e posedon, prandaj nuk mund të sjell fokus të mire të dritës, duke pamundësuar krijimin e një ambienti të këndshëm dhe pa reflektime të panevojshme të dritës. Me përdorimin e çipave (qelulave) të tillë arrihet intensitet shumë më i lartë, fokusim dhe shpërndarje e përkryer e fluksit të dritës.

4) LED moduli: Moduli dhe ne veçanti secili çip i ndriçuesit duhet ta kenë mundësinë qe te ndërrohen ne vend ne rastin e nevojës për servisim
Ndriçuesi i prezantuar nga OE N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K. nuk e ka këtë mundësi dhe në rast të prishjes së ndonjërës nga qelulat e ndriçuesit duhet të ndërrohet i tërë ndriçuesi me një të ri që gjithashtu shkakton dëmtime të buxhetit.

5) Shtëpiza e ndriçuesit: Shtëpiza duhet të jetë e punuar nga alumini i derdhur nën shtypje dhe ta ketë mundësinë e hapjes pa mjete të punës në rastin e nevojës për servisim.
Ndriçuesi i prezantuar nga N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K nuk e posedon këtë mundësi dhe lehtësi gjatë punës.

6) Këndi i rrotullimit të ndriçuesit:
-15°, -10°, -5°, 0°, 5°, 10°, 15°, 0°-90°
Me këtë karakteristikë ekziston mundësia e përshtatjes së ndriçuesit në kënde të shumta dhe të ndryshme, në mënyrë që ndriçimi i ambientit të jetë sa më efikas, ndërsa ndriçuesi i prezantuar nga N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K nuk e ka këtë mundësi.

7) Çertifikatat: Ndriçuesi duhet te ketë çertifikatat: CE LVD, CE EMC, IK10, RoHS, ENEC, lm80.
Operatori ekonomik i lartcekur nuk e ka prezantuar asnjërën nga çertifikatat e kërkuara.

8) Në pikën e paramasës, e cila përshkruan karakteristikat teknike të ndriçuesit rrugor kërkohet që efikasiteti ndriçimit për ndriçuesit LED të jetë 170lm/W, ndërsa ndriçuesi i prezantuar nga N.M.I.Q. Montkomerce SH.P.K i ka vetëm 135lm/W, kështu që i njëjti nuk e plotëson as këtë kërkesë të përcaktuar në dosje të tenderit.
Sipas kësaj që është thënë më lartë, ndriçuesi rrugor i prezantuar nga OE i lartcekur në katalogun e dhënë as përafërsisht nuk i plotëson kërkesat sipas paramasës së projektit.
Ndriçuesit e përshkruar dhe të paraqitur në katalog janë jo kualitativ në krahasim me ndriçuesit e kërkuar me paramasë, janë me çmim shumë më të ultë në treg, se sa ndriçuesit e përshkruar dhe si të tillë (duke e marrë parasysh numrin e tyre total të paraparë me projekt) krijojnë diferencë të madhe në vlerë totale të shprehur në Euro, nga ajo që sipas tregut realisht është, por edhe nga vlera e paraparë me dosje të tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë, e po ashtu edhe OE të tjerë janë të papërgjegjshëm dhe është dashur të konsiderohen edhe nga ana e AK-së si të tillë, dhe jo të rekomandohet për kontratë, ndërsa të tjerët të cilësohen si të pasuksesshëm, mirëpo që një veprim të tillë AK-ja nuk e ka bërë duke na diskriminuar neve ku edhe pse jemi OE i përgjegjshëm nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Ne me dt.31.08.2021 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e AK-së, ku e njëjta nuk e ka arsyetuar vendimin për refuzim me fakte konkrete dhe nuk i është përgjigjur në tërësi pretendimeve tona ankimore.

AK-ja në lidhje me pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë e ka cekur se:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik **"BM Group"sh.p.k,** i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është i pasuksesshëm për arsye se nuk qe tenderi me çmimin me te ulet ne mesin e tetnderëve që plotësojnë kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT.

Arsyetimi i lartcekur i AK-së tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse nëse do të ishte e kundërta atëherë AK-ja do ta dëshmonte të kundërtën e pretendimeve tona me fakte dhe dëshmi konkrete dhe duke ju përgjigjur secilit pretendim tonit ankimor. Mirëpo përderisa e njëjta një veprim të tillë nuk e ka bërë, por është përgjigjur sipas arsyetimit të lartcekur ky fakt tregon qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara.

Arsyetimi i lartcekur i AK-së bie në kundërshtim me paragrafin 12 të nenit 108/A të LPP-së në të cilin ceket shumë qartë se *"12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni,* ***duhet të jenë të arsyetuara*** *dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë."* Përderisa AK-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret në lidhje me pretendimet tona ankimore atëherë është shumë e qartë se nuk është respektuar dispozita e nenit të lartcekur.

Po ashtu AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore kundrejt OE të tjerë të cilët AK-ja në njoftimin mbi vendimin e saj i ka shpallur si të papërgjegjshëm, duke i anashkaluar në tërësi pretendimet tona ankimore.
Ky veprim nga ana e AK-së edhe një herë e tregon diskriminimin që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm, sepse nëse eventualisht pretendimet tona nuk do të qëndronin atëherë AK-ja do ti kishte refuzuar me fakte dhe dëshmi konkrete, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë dhe ky fakt tregon qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet qartë se qëllimi i AK-sw është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Në të njëjtën kohë AK-ja e ka favorizuar OE e rekomanduar për kontratë duke e shpallur fitues në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse trajtimi dhe vlerësimi i operatorëve ekonomik duhet të bëhet në mënyrë të barabartë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Multi Business Group" SH.P.K.**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*